



**Sistemi i
Hyrje-
Daljeve**

Udhëtimi në Evropë

Një sistem modern, më i efektshëm i menaxhimit të kufirit për Evropën

Sistemi i regjistrimit të hyrje-daljeve (EES) është sistemi i ri evropian për menaxhimin e kufijve. Ky sistem do të përdoret për regjistrimin e shtetasve nga vende që nuk janë anëtare të Bashkimit Evropian dhe që udhëtojnë për një periudhë afatshkurtër, sa herë që këta shtetas kalojnë kufijtë e jashtëm të **29 vendeve evropiane**.

Duke nisur nga data **12 tetor 2025**, të 29 shtetet evropiane që përdorin EES-në do ta vënë gradualisht në funksionim sistemin në kufijtë e tyre të jashtëm gjatë një periudhe gjashtëmujore.

Gjatë kësaj periudhe, të dhënat e udhëtarëve mund të mos mbledhen menjëherë në çdo pikëkalimi të kufirit.

Me përfundimin e vënies në funksionim, EES-ja do të jetë në përdorim të plotë në të gjitha pikëkalimet e kufirit të jashtëm.





Cilat shtete evropiane e përdorin EES-në?

Austria, Belgjika, Bullgaria, Kroacia, Republika Çeke, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Islanda, Italia, Letonia, Lihtenshteini, Lituania, Luksemburgu, Malta, Holanda, Norvegjia, Polonia, Portugalia, Rumania, Sllovakia, Sllovenia, Spanja, Suedia, dhe Zvicra.

Kush do të regjistrohet në EES?

Shtetasit që vijnë nga vende që nuk janë anëtare të BE-së dhe që udhëtojnë për në vende evropiane që e përdorin EES-në për qëndrimet afatshkurtra (90 ditë brenda 180 ditëve), do të regjistrohen në EES.

Të dhënat e udhëtarëve do të regjistrohen në EES, pavarësisht nëse u duhet vizë për qëndrim afatshkurtër apo mund të udhëtojnë pa vizë. Disa udhëtarë përjashtohen nga regjistrimi (shihni pjesën "Përjashtime"). Edhe refuzimet e hyrjes regjistrohen në sistem.

EES-ja nuk do të shtojë kërkesa të reja për personat që janë në gjendje të udhëtojnë lirisht në Evropë (shihni "Përjashtime").

Çfarë të dhënash mblidhen nga EES-ja?

- Të dhëna personale nga dokumenti i udhëtimit si emri i plotë, data e lindjes, shtetësia;
- Data dhe vendi i secilës hyrje dhe dalje nga 29 shtetet evropiane që e përdorin EES-në;
- Të dhëna biometrike si imazhi i fytyrës dhe/ose gjurmët e gishtave;
- Informacion për refuzimin e hyrjes, sipas rastit.



Pse po futet sistemi i ri EES?



EES-ja modernizon kontrollin në kufi dhe e ul gradualisht kohën e pritjes në kufij.



EES-ja i identifikon lehtësisht shtetasit që nuk vijnë nga vende të BE-së, të cilët nuk i përmbushin kushtet për hyrje dhe qëndrim ose ata që qëndrojnë më gjatë nga sa u lejohet në zonën e Shengenit.



EES-ja forcon sigurinë në kufijtë e Evropës.



Privatësia

Të dhënat e udhëtarëve do të mbliidhen dhe do të ruhen në respektim të plotë të rregullave dhe të të drejtave për mbrojtjen e të dhënave në BE. Për më shumë informacion për mbrojtjen e të dhënave dhe mënyrën se si mund të ushtroni të drejtat tuaja në këtë drejtim, përfshirë të drejtën për të kërkuar qasje në të dhënat tuaja apo për të kërkuar ndryshim të tyre, vizitoni <https://travel-europe.europa.eu/ees/data-held-bv-ees>



Kush mund të ketë qasje në të dhënat e udhëtarëve?

- *Autoritetet e kufirit, të vizave dhe të migracionit në shtetet evropiane që përdorin EES-në;*
- *Autoritetet ligjzbatuese në shtetet evropiane që përdorin EES-në dhe Europol;*
- *Në kushte të rrepta, të dhënat e udhëtarëve mund të transferohen në një shtet tjetër brenda ose jashtë BE-së apo në një Organizatë Ndërkombëtare;*
- *Entitetet e transportit - vetëm për të verifikuar nëse mbajtësit e një vize për qëndrim afatshkurtër e kanë përdorur numrin e hyrjeve të autorizuar nga viza e tyre.*

Programet kombëtare të lehtësimit

Shtetet evropiane që përdorin EES-në mund të zbatojnë Programe kombëtare të lehtësimit me qëllim lehtësimin e kalimit të kufirit për shtetasit nga vende që nuk janë anëtare të BE-së e që udhëtojnë shpesh për në Evropë.

Këto programe mund të gjejnë zbatim në një ose disa vende evropiane.

Për të mësuar nëse përfitonit nga një Program kombëtar lehtësimi, vizitoni <https://travel-europe.europa.eu>

Përrjashtime

EES-ja nuk do të zbatohet për sa më poshtë:

- Shtetasit e vendeve evropiane që përdorin EES-në, si dhe të Qipros dhe të Irlandës
- Shtetasit nga vende joanëtare të BE-së, të cilët kanë një kartë qëndrimi dhe kanë lidhje të drejtpërdrejtë me shtetas të BE-së
- Shtetasit nga vende joanëtare të BE-së, të cilët kanë një kartë apo leje qëndrimi dhe kanë lidhje të drejtpërdrejtë me një shtetas nga vende joanëtare të BE-së, që mund të udhëtojnë në Evropë si një shtetas i BE-së
- Shtetasit nga vende joanëtare të BE-së, të cilët udhëtojnë për arsye transferimi brenda shoqërisë ku punojnë ose për qëllime kërkimi shkencor, studimi, trajnimi, shërbimi vullnetar, të skemave të shkëmbimit të nxënësve ose të projekteve arsimore, si dhe për kujdestarët e fëmijëve që jetojnë me atë familje (au-pairing)
- Personat që kanë leje qëndrimi dhe vizë

qëndrimi afatgjatë

- Shtetasit e Andorras, Monakos, San Marinos, dhe mbajtësit e një pasaportë të lëshuar nga Shtet-Qyteti i Vatikanit ose Selia e Shenjtë
- Personat e përjashtuar nga kontrollet në kufi ose që u janë dhënë disa privilegje sa u takon kontrolleve në kufi
- Personat që kanë një leje të vlefshme lokale për lëvizjet kufitare
- Anëtarët e ekuipazhit të trenave për pasagjerë dhe ata për mallra në udhëtime me lidhje ndërkombëtare

Për të mësuar më shumë për arsyet e përjashtimit nga EES-ja, vizitoni



<https://travel-europe.europa.eu>